



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE KORÇË

NOTER BLEDAR E. ZAKE
ADRESA Lagje Nr.6, Rr. "Floresha
Myteveli".
TEL: 0694086756

KONTRATË DHURIMI PASURI E

LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2827


Nr. koleksioni: 1890

Korce më 07/06/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

***Akti noterial përbëhet nga 3 fletë**



A2023033560205838531



A2023033560205838531

KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 03/06 .2023, para meje Noter BLEDAR E. ZAKE, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore KORÇË, me zyrë në adresën Korçe, Lagje Nr.6, Rr. "Floresha Myteveli", u paraqit personalisht:

DHURUES: Maksim Fejzulla, atësia Hysen, amësia Meleke, shtetas Shqiptar, lindur në Rehovë, Korçë dhe banues në KORÇË, me adresë Kongresi I Lushnjes 02330144; Nd. 49; H. 1; Korçë; Korçë; 7001; Korçë, lindur më 20/02/1955, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038755077 dhe nr. personal F50220316F. *(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Dhuruesi")*

DHËNËSE PËLQIMI: Diana Fejzulla, atësia Janaq, amësia Aleksandra, shtetase Shqiptare, lindur në Maliq, Korçë dhe banuese në KORÇË, me adresë Kongresi I Lushnjes 02330144; Nd. 49; H. 1; Korçë; Korçë; 7001; Korçë, lindur më 20/07/1962, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034044307 dhe nr. personal G25720041O. *(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Dhuruesi")*

PRANUES I DHURIMIT: Marjela Peri, atësia Dhimitraq, amësia Diana, shtetase Shqiptare, lindur në Korçë dhe banuese në TIRANË, me adresë E Kavajës; Nd. 233; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 07/01/1987, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033415469 dhe nr. personal I75107091T. *(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Përfituesi i dhurimit")*

BAZA LIGJORE

Referuar dispozitave ligjore: Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" Ligji nr.9723 datë 03.05.2007 Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit" i ndryshuar. Kodi CivilAkt themelimi dhe Statuti i Shoqërisë Vendimi i Ortakut.

Neni 1**OBJEKTI**

Mbi bazën e të Ortakut. Mbi bazën e ekstraktit të Shoqërisë Korsel shpk. Mbi bazën e dokumentave të sipercituara, përpilojmë këtë kontratë dhurimi kuotash me kusht. Ortaku i vetëm z. Maksim Fejzulla, të gjitha kuotat në masën 100 % të kapitalit me vlerë 223.600.000,00 leke, në numër kuotash 22.360,00 që zotëron në kapitalin e Shoqërisë "Korsel" shpk, ju dhuron znj. Marjela Peri, pa asnjë interes të tashëm apo të ardhshëm. Nderkohe edhe dhenesja e pelqimit bashkeshortja e ortakut të vetëm znj. Diana Fejzulla (pasí kjo shoqëri është krijuar gjatë martesës) jep pelqimin për realizimin e kësaj kontrate dhurimi. Znj. Marjela Peri e mirepret dhe e pranon këtë kontratë dhurimi, pa asnjë kusht dhe pretendim.

NENI 2**VLERA E SENDIT TË DHURUAR**



A2023033560205838531

Dhuruesi bie dakort te dhuroje dhe ti transferoje pranusit te dhurimit i cili i pranon te gjithë pasurine e dhuruar, te gjitha kuotat ne masën 100% te kapitalit 223.600.000,00 leke, ne numer kuotash 22.360,00. Palet konfirmojne se ky dhurim kryhet pa kurrfarë interesi të tanishëm apo të mëvonshëm, barrëapo detyrimi ndaj te tretëve.

NENI 3

TRANSFERIMI I KUOTAVE

Transferimi i kuotave objekt kontrate do të behet efektiv me rregjistrimin e kësaj kontrate në Rregjistrimin e Kuotave te Shoqërisë, si dhe në QKR Tirane. Dhuruesi i kuotave është dakort që Shoqëria të kalojë në emër të pranuesit te dhurimit që në momentin e rregjistrimit të kësaj kontrate.

Neni 4

DEKLARIMET DHE GARANCITË E DHURUESIT

Dhuruesi deklaron dhe garanton se: Është pronar i vetem ligjor dhe perfitues i vetëm i kuotave të përshkruara në këtë kontratë. Kuotat objekt kontrate janë shlyer plotësisht. Kuotat janë të lira ga cdo lloj barre, pengu, apo detyrimi tjetër dhe dhuruesi ka të drejta të plota pushtet dhe autoritet për ti transferuar ato në përputhje me kushtet e kësaj kontrate dhurimi. Dhuruesi garanton Pranuesin e Dhurimit se në momentin e ekzekutimit të kësaj kontrate në rregjistrimin e kuotave të anëtarësisë së Shoqërisë së thjeshtë dhe në QKB, kuotat, objekt kontrate i japin pranueses titullin e pronësisë mbi këto kuota si dhe cdo të drejtë që lidhet me zotërimin e tyre.

NENI 5

LIGJI I ZBATUESHËM

Te drejtat dhe detyrimet e palëve të kësaj kontrate do të rregullohen dhe interpretohen në përputhje me legjislacionin shqiptar, Kodi Civil i RSH.

Neni 6

ZGJIDHJA E MOSMARËVESHJEVE

Mosmareveshjet që mund të lindin nga interpretimi i kësaj kontrate do të zgjidhen nëpërmjet palëve me mirëkuptim dhe nëse nuk arrihet kjo, mosmarëveshjet do të zgjidhen ne rrugë gjyqësore, duke përcaktuar si gjykatë kompetente Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë

Neni 7

TË NDRYSHME

Kjo kontrate e shkruar përben marrëveshje e plotë ndërmjet palëve, përse i përket objektit të kësaj kontrate dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, verbale apo të shkruara dhe të gjitha komunikimet e tjera të mëparshme ndërmjet palëve në lidhje me objektin në fjalë.



A2023033560205838531

Me hartimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate si më sipër shkruar z.Maksim Fejzulla si ortak i vetem i Shoqërisë Korsel shpk zhvishet nga pronësia mbi kuotat në masën 100% të kapitalit me vlerë 223.600.000,00 leke, në numer kuotash 22.360,00 në kapitalin e Shoqërisë Korsel shpk dhe deklarohet se heq dorë nga cdo e drejtë për të kërkuar përfitime të cdo lloji nga të qënit si ish ortak i vetem i Shoqërisë, po ashtu heq dorë përfundimisht mbi cdo pretendim mbi dividendet dhe cdo përfitim tjetër nga aktiviteti i Shoqërisë, duke pranuar me vullnetin e tij të lirë këtë transaksion. Mbas nënshkrimit të këtij akti, si më sipër shkruar, e pasqyrimin në QKB Shoqëria pëson këtondryshime:

Ishte:

Korsel shpk me ortak të vetëm: Z.Maksim Fejzulla zotërues i 100% të kuotave të kapitalit në Shoqëri.

Behet:

Shoqëria Korsel shpk me ortak të vetëm :

Marjela Peri, zotërues e 100 % të kuotave të kapitalit në Shoqëri.

Autorizohet Administratori ose cdo person autorizuar nga Administratori të ndjeke procedurën për pasqyrimin e Aktit në QKB.

Kjo kontrate u përpilua në tre kopje me vlerë të njëjtë ligjore, e cila iu lexua palëve të interesuara me zë të lartë e të qartë dhe mbasi u gjet e përpiluar në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë dhe me Ligjin, u nënshkrua rregullisht. Sipas ligjit une Noteri pasi verifikova identitetin e palëve dhe dokumentacionin përkatës e vërtetoj atë rregullisht.

DHURUES

MAKSIM FEJZULLA

PRANUES I DHURIMIT

MARJELA PERI

DHËNËSE PËLQIMI

DIANA FEJZULLA



NOTER

BLEDAR E. ZAKE

VENDIM I ORTAKUT TË VETEM TE SHOQËRISË

KORSEL SHPK NIPT J64104124G

Sot në datë 07.06.23, unë Maksim Fejzulla ortaku i vetëm i Shoqërisë Korsel shpk me 100 % të kapitalit, në përputhje me parashikimet e Statutit të Shoqërisë dhe Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, në mënyrë unanime vendos:

Të dhuroj 100 % të kapitalit të Shoqërisë Korsel shpk në vlerën 223.600.000,00 leke, në numer kuotash 22.360,00 znj.Marjela Peri identifikuar me ID nr. I75107091T duke mos patur asnjë pretendim, si tani ashtu dhe në të ardhmen.

SHOQËRIA KORSEL SHPK

ADMINISTRATOR

MAKSIM FEJZULLA

Maksim Fejzulla

